

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit N. P., nga Prishtina, për shkak të veprës penale rrezikimi i personave në mbrojtjen ndërkombëtare nga neni 173 par. 4 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr. 4/2015 datë 16.09.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr. 524/2015 datë 8 dhjetor 2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7 prill 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit N. P., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr. 4/2015 datë 16.09.2015 dhe aktgjykimi të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr. 524/2015 datë 8 dhjetor 2015 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr. 4/2015 datë 16.09.2015, i dënuari N. P. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikim i personave në mbrojtje ndërkombëtare nga neni 173 par. 4 të KPK dhe për

këtë vepër i është shqiptuar dënimi me kusht ashtu që i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër tjetër penale. Në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23.12.2014 e gjer më 24.02.2015 dhe në arrest shtëpiak nga 24.02.2015 gjer më 31.03.2015. Është detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar, Ambasada Amerikane Prishtinë për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr. 524/2015 datë 8 dhjetor 2015.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari N. P. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr. 52/2016 datë 22.03.2016, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë, i dënuari N. P. konsideron se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si në vijim:

-të nenit 384 par. 1 pika 8 të KPPK, sepse aktgjykimet mbështeten në prova të papranueshme respektivisht vetëm në raportin e shefit të sigurimit të Ambasadës Amerikane i dorëzuar policit V. Z. ndërsa nuk është marrë në pyetje dëshmitari shefi i sigurimit në mënyrë që t'i ofrohet mundësia që ta kundërshtojë provën në fjalë;

-nenit 384 par. 1 pika 3 të KPPK, sepse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa mbrojtësin, prania e të cilit në shqyrtimin gjyqësor kërkohet me ligj dhe kështu është shkelur e drejta e tij në mbrojtje;

Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, ngase aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 12 lidhur me nenin 370 të KPPK.

Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë theksohet se i dënuari N. P., është shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i personave në mbrojtjen ndërkombëtare nga neni 173 par. 4 të KPK, në të cilin theksohet "...se në muajin maj të vitit 2012 kjo Ambasadë e kishte larguar nga puna për shkak se kishte pasur një rast dhune në familje dhe pas largimit nga puna në shenjë revolte, i akuzuari në përpjekje për t'u kthyer sërish në punë kishte filluar t'i kërcënojë dhe rrezikoj punëtorët e Ambasadës duke shkruar dhe dërguar letra të shumta Ambasadorit, burimeve njerëzore të Ambasadës, gazetave lokale, duke postuar ankesa në faqet sociale të medieve të Ambasadës, ku punonjësit e Ambasadës janë ndjerë të shqetësuar dhe të kërcënuar ngase ai mund të merr veprime drastike kundër tyre, pasi që kishte filluar të bëjë lëvizje të shumta dhe të rrezikshme me veturën e tij në afërsi të Ambasadës Amerikane në Prishtinë".

Sipas nenit 173 par. 4 të KPK, këtë veprë penale e kryen personi që bënë kanosje serioze se do të kryejë veprën penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 të këtij neni. D.m.th., për ekzistimin e kanosjes në kuptim të kësaj dispozite duhet që personit të cilit i drejtohet t'i bëhet e qartë se çfarë e keqe do godas si dhe, që ai person do t'i shkaktojë të keqen.

Kështu, siç është ndërtuar dispozitivi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se koha e ndërmarrjes së këtyre veprimeve dhe cilat janë ato veprime konkrete që i janë drejtuar të

dëmtuarve si dhe kush kanë qenë personat që janë ndier të kërcënuar nga veprimet e te akuzuarit. I dënuari nuk ka mohuar faktin se i është drejtuar mjeteve të informimit lidhur me ankesat e tij për shkak të shkëputjes së marrëdhënies së punës në Ambasadën Amerikane, sikurse që nuk e ka mohuar faktin se ka bërë grevë urie para Ambasadës dhe, se i është drejtuar ambasadorit dhe zyrës për resurse njerëzore në Washington. Pohon se të gjitha këto veprime i ka bërë me qëllim që zëri i tij të dëgjohet e jo për ndonjë qëllim tjetër, ndërsa asnjëherë askujt nuk i është kërcënuar. Gjykata në një situatë të këtillë është dashur që të administroj të gjitha provat e nevojshme për të vërtetuar gjendjen faktike lidhur me veprimet e të dënuarit. Kundërthënie tjetër në mes të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë qëndron në atë se në dispozitivin e kësaj gjykimesi nuk është specifikuar koha e kryerjes së veprës, në raportin e oficerit të Sigurimit të Ambasadës Amerikane, është precizuar se në muajin maj 2014, i dënuari ka bërë grevë urie para ambasadës e më pas ka vazhduar me postimin e ankesave-njoftimet në rrjetet sociale dhe media.

Nga shkresat e çështjes dhe aktgjykimet e kundërshtuara rezultojnë që të dy gjykatat vendimet e tyre, i bazojnë ekskluzivisht mbi një shkresë-raport të drejtuar policisë nga shefi i sigurimit të Ambasadës Amerikane z.M. R. i datës 23.12.2014 nga e cila rezulton se ky zyrtarë kishte kërkuar ndihmë në lidhje me ish punonjësën e tyre tani të dënuarin. Në këtë raport është konstatuar se i dënuari N. P., ka punuar në Ambasadën Amerikane gjatë vitin 2012 dhe për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës i dënuari vazhdimisht ka ngacmuar Ambasadën me letra të shumta dërguar ambasadorit, burimeve njerëzore të ambasadës dhe gazetave lokale në një përpjekje për t'u pranuar sërish në punë. Sipas këtij raporti Ambasada kur nuk i është përgjigjur këtyre veprimeve, për çfarë i dënuari në vitin 2014 kishte bërë një grevë urie para Ambasadës për 5 ditë e më pas i njëjti fillon t'i postonte ankesat e tij në faqet sociale të medieve të Ambasadës. Ambasada edhe më tej ka injoruar njoftimet e tij. Sipas këtij raporti, i dënuari kishte vazhduar fushatën e tij duke postuar ankesat e tij në mediet sociale të ambasadave të SHBA-së që gjenden në Evropë dhe në disa ambasada tjera jashtë zonës së Evropës ndërsa, përveç kësaj ai kishte filluar t'i publikoj edhe emrat e punonjësve të Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë për të cilat mendonte se kanë kontribuar në largimin e tij nga puna. Përveç këtij raporti në shkresat e çështjes nuk ka asnjë provë tjetër si p.sh.,

korrespondenca përmes postës elektronike në mes të dënuarit dhe institucioneve të cilave ju janë adresuar, madje as emrat e pretenduar të punonjësve të Ambasadës të cilit janë ndjerë të kërcënuar, kështu që në rastin konkret rezulton se këtu nuk kemi një situatë të qartë apo të bazuar në prova të administruara. Nga ana tjetër në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë në faqen 3 vetëm është bërë citimi i raportit në fjalë në bazë të të cilit gjykata nxjerr përfundime lidhur me fajësinë e të dënuarit, ndërsa në faqen 4 duke vlerësuar mbrojtjen e të dënuarit gjykata ka konstatuar “...por, nuk e aprovoi mbrojtjen ngase e njëjta nuk është mbështetur në asnjë provë materiale që do të bindte gjykatën që të nxirrte aktgjykim lirues, për më tepër ajo është në kundërshtim me raportin e shefit të sigurimit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë dhe raportin e policit V. Z., në të cilat thuhet se personeli i Ambasadës Amerikane në Prishtinë është ndier i shqetësuar dhe kërcënuar nga veprimet e të akuzuarit N. P.”.

Një konstatim i këtillë është plotësisht i paqartë sepse nuk mund të kuptohet se në çfarë kuptimi mbrojtja e të dënuarit është në kundërshtim me raportin e zyrtarit të sigurimit të Ambasadës, ngase siç del nga ky raport nga i njëjti nuk mund të kuptohet çfarë veprimesh konkrete i ka ndërmarr i dënuari sepse përveç konstatimeve të cilat nuk kanë qenë kontestuese, nuk janë specifikuar veprimet konkrete inkriminuese. Ndërsa, në shkresat e çështjes përveç të këtij raporti dhe raportit të policit V. Z., i cili është vetëm interpretimi i raportit të zyrtarit të Sigurimit të Ambasadës, nuk ka asnjë provë tjetër për të mbështetur përfundimet e këtilla të gjykatës.

Edhe gjykata e shkallës së dytë, ndonëse ka qenë e detyruar që në harmoni me dispozitën e nenit 394 të KPPK, këto shkelje t’i shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe t’i evitoj shkeljet e tilla, këtë nuk e ka bërë, të cilat shkelje kanë pamundësuar vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të kundërshtuara.

Në rigjykim, gjykata duhet t’i evitoj paqartësitë dhe kundërthëniet e lartcekura, të administroj të gjitha provat në të sigurohen korrespondenca e të dënuarit përmes postës elektronike me qëllim që të vërtetohet përmbajtja e tyre a ishin ato kërcënuese apo jo, si dhe provat tjera të cilat gjykata konsideron si të nevojshme për vërtetimin e të gjitha fakteve

relevante në këtë çështje penale dhe pas vlerësimit të tyre të nxjerr një vendim të ligjshëm duke pasur parasysh edhe pretendimet tjera të paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.78/2016, më 7 prill 2016

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetari i kolegjit,
Avdi Dinaj